



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 187/4 Prot

Tiranë, më 12.04.2016

**VENDIM**

Nr. 14, datë 12.04.2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" i ndryshuar, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit spitali "SALUS" sh.a. me NUIS K82311006T,

**VËREJ SE :**

Në zbatim të Urdhrit nr. 29, datë 16/02/2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer hetim administrativ pranë kontrolluesit spitali "SALUS" sh.a., me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit spitali "SALUS" sh.a., i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të procesverbalit të kontrollit administrativ dhe provave të administruara konstaton se:

1. Kontrolluesi e ka plotësuar detyrimin për "*Njoftim*" referuar nenit 21 të ligjit. Gjatë verifikimit të përmbajtjes së "*Njoftimit*", është konstatuar se kontrolluesi nuk e ka kryer përditësimin, sipas nenit 22 të ligjit, sidomos në lidhje me deklarin e palëve të treta, të cilat aksesojnë të dhëna personale nga marrëdhënia kontraktuale me kontrolluesin.
2. Kontrolluesi ka kontratë me palë të treta si: "*Digitalb*" sh.a. dhe "*Akt Marrëveshje*", me Shoqërinë e sigurimeve "*INSIG*" sh.a. në lidhje me kryerjen e "*check up*" të punonjësve të Digitalb apo subjekteve të siguruar pranë kompanisë "*INSIG*" sh.a. Parë në frymën e Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, nenet 27 dhe 28 të tij, është konstatuar se aktmarrëveshjet nuk janë në përputhje me Udhëzimin Nr.19 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve midis kontrolluesit dhe përpunuesit...*".

### 3. Kontrolluesi:

- a. Në "Akt Marrëveshjen" me "INSIG" sh.a., pika 7.2 ka parashikuar: "Dokumentet dhe informacionet që do të merren nga Institucioni shëndetësor gjatë punës të tij janë konfidenciale dhe për përdorim ekskluziv nga INSIG sh.a. Institucioni nuk duhet të bëjë të njohur, (të mos shtypë drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt dhe/ose kopje, dhe/ose tregojë, dhe/ose përdorë) këto materiale dhe informacione konfidenciale për palët e treta pa aprovimin paraprak të INSIG" sh.a. Në këtë Akt Marrëveshje nuk është parashikuar e drejta e aksesit në të dhënat shëndetësore për subjektet e të dhënave (siguruarit), të cilët janë objekt të kësaj kontrate për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore pranë spitalit "SALUS", dhe për më tepër, është cilësuar se këto të dhëna do të jenë për përdorim ekskluziv nga INSIG sh.a.
- b. Në kontratën e bashkëpunimit me "Digitalb" sh.a. nuk është parashikuar fare e drejta e aksesit për subjektet e të dhënave (siguruarit), të cilët janë objekt të kësaj kontrate për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore pranë spitalit "SALUS".

Këto Akt Marrëveshje dhe Kontrata Bashkëpunimi nuk kanë të parashikuara kushtet e nevojshme teknike dhe organizative në përmbushjen e detyrimeve për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale.

Në përfundim të procedurës së inspektimit në datë 24.03.2016, është mbajtur procesverbali i kontrollit administrativ, në të cilin nga kontrolluesi nuk u paraqitën pretendime.

Në zbatim të neneve 93 e vazhdim të Ligjit Nr.8485/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", përpara marrjes së vendimit përfundimtar, në datë 05.04.2016 është organizuar seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të kontrollit administrativ. Në këtë seancë kontrolluesi spitali "SALUS" sh.a., paraqiti pretendimet me shkrim, të cilat konsistojnë:

1. Shteti i së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete detyrimin e autoriteteve publike qendrore apo lokale për të shprehur vullnetin e tyre në çdo rast kur i kërkohet nga ligji nëpërmjet akteve administrative (neni 15 i K.Pr.A), të cilat nuk duhet të përbejnë "flatus vocis" por duhet të përfaqësojë cilësinë e efektive të ushtrimit të aktivitetit administrativ sjellja e të cilit duhet të jetë legjitime (neni 9 i K.Pr.A), i drejtë dhe i paanshëm (neni 12 i K.Pr.A), i hapur dhe bashkëpunues me personat privatë (neni 13 i K.Pr.A).
2. Përfundimet e arritura nga grupi i Inspektorëve dhe në mënyrë të veçantë që në depozitimin e këtij akti një personi të paautorizuar nga shoqëria apo akoma më keq një shtetasi të huaj i cili jo vetëm nuk e kupton gjuhën shqipe por i është transmetuar në mënyrë jo korrekte se procesverbali kishte të bënte vetëm me kërkesën për marrje dokumentacioni shtesë. Në momentin që inspektorët kanë konstatuar një element të huaj (shtetas të huaj) i cili nuk kishte njohuri në gjuhën shqipe apo nuk gëzonte ndonjë tagër për të përfaqësuar shoqërinë duhet të kërkonin përfaqësuesit legjitim për të depozituar një akt nga i cili shoqëria tërheq të drejta dhe detyrime (neni 35 i ligjit nr. 44/2015)
3. Kemi bërë përditësime në formularin e njoftimit vërtetuar me shkresën 357 datë 28.07.2015.

4. Në procesverbalin e mbajtur konstatohet se kontratat e lidhura me Digitalbin dhe INSIG janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 19 datë 03.08.2012 *"Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit dhe përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e kontratave tip në rastet e delegimit."* ku nuk specifikohet se cila pjesë e kontratës është në kundërshtim me ligjin dhe këtë udhëzim.
5. Në procesverbal pretendohet se në kontratën e Digitalbit apo INSIG pacientëve u mohohet e drejta e aksesit parashikuar nga neni 12 i ligjit. *"Përveç palëve të treta të cilat janë çdo subjekt tjetër përveç subjektit të të dhënave personale e cila kjo kontratë u garanton konfidencialitet. Për më tepër nuk ka asnjë rast ankimi potencial i tashëm apo në të ardhmen ku ndonjëri nga pacientët të jetë ankuar në lidhje me refuzimin e infrastrukturës shëndetësore. Në këto kushte një pretendim i tillë është i pabazuar në aktet e analizuara gjatë procedimit administrativ."*

Pretendimet të paraqitura në seancë dëgjimore nuk qëndrojnë për arsyet e mëposhtme:

1. Zyra e Komisionerit ka ushtruar kontroll në vitin 2013. Në lidhje me gjetjet e konstatuara Komisioneri ka dalë me aktin Rekomandim Nr.16, datë 01.08.2013 dhe jo Vendim. Aktiviteti administrativ i ushtruar nga inspektorët e zyrës së komisionerit është në përputhje dhe zbatim të nenit 15, paragrafi 2 të Kodit të Procedurave Administrative.
2. Lidhur me pretendimin sa i përket dorëzimit të *"Procesverbalit të Inspektimit Administrativ"* pranë kontrolluesit:
  - a) Grupi i inspektimit ka kërkuar takim me personin e kontaktit dhe në mungesë të tij, është pritur nga një përfaqësues tjetër, shtetas italian, prezantuar në cilësinë e Sekretarit të Spitalit SALUS.
  - b) Grupi i inspektimit i ka kërkuar përfaqësuesit të kontrolluesit praninë e një përkthyesi, i cili është thirrur prej tij dhe ka qenë prezent gjatë gjithë takimit.
  - c) Neni 44/2015 i Kodit të Procedurave Administrative i përmendur në këtë parashtrim, është nen i Kodit të ri të Procedurave Administrative, i cili nuk ka hyrë akoma në fuqi, pra nuk mund të përdoret si referencë.
  - d) Nisur nga fakti që, proces verbali është firmosur dhe vulosur me vullnet të lirë, do të thotë që përfaqësuesi i kontrolluesit ka qenë i mirë informuar lidhur me çfarë është nënshkruar.
  - e) Në zbatim të detyrimeve Kushtetuese, neni 14, paragrafi 1: *"Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja"*.
3. Në lidhje me pretendimin se është kryer përditësimi, duke ju referuar shkresës nr.357 protokollit, datë 28.07.2015, rezulton se shkresa në fjalë, është dërguar pranë Zyrës së Komisionerit me objekt transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale. Konstatimi në procesverbal i referohet nenit 22 të ligjit, mbi përmbajtjen e njoftimit. Në *"Njoftimin"* e bërë pranë zyrës së komisionerit, rubrika 7 e formularit të njoftimit, është deklaruar se nuk ka përhapje të dhënash. E kundërta rezulton e vërtetë, për faktin se në marrëdhëniet me palët e treta si shoqëri sigurimi, banka, tatime, qendra e transfuzionit të gjakut etj., kontrolluesi spitali SALUS përhap të dhëna në bazë të një detyrimi ligjor apo në funksion të një Akt Marrëveshje respektive.

4. Në lidhje me pretendimin se kontratat e lidhura me Digitalbin dhe INSIG janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 19 datë 03.08.2012 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit dhe përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e kontratave tip në rastet e delegimit.", Zyra e Komisionerit konkludon se kontrolluesi spitali "SALUS", si në kushtet e kontrolluesit po ashtu edhe të përpunuesit, duhet të aplikojë këtë udhëzim në rastin e kontratave të ngjashme.
5. Në lidhje me pikën e pestë të pretendimeve, kontrolluesi është konfuz dhe i paqartë dhe pa një arsyetim ligjor.  
Parë në frymën e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, rezultoi se kontrolluesi është në shkelje të nenit 20 të tij, duke mohuar të drejtën e aksesit të subjekteve të të dhënave parashikuar në nenin 12 të ligjit. Detyrimet e kontrolluesit dhe të përpunuesit, për të krijuar kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit dhe për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale (neni 20, paragrafi 1, gërma "c"), janë taksative dhe të qarta.

Si përfundim, Zyra e Komisionerit konkludon se shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbën "**kundërvajtje administrative**" dhe sanksionohet me gjobë.

- ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

Kontrolluesi, spitali "SALUS" sh.a., në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2 për kundërvajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin që shkelja ka të bëjë me detyrimin për informimin e subjekteve të të dhënave për të drejtën për akses, të drejtën për korrigjimin e tyre, si dhe detyrimet që i dalin kontrolluesit në zbatimin e Ligjit nr.9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të nenit 20, 22, 27 dhe 39/1 gërma "ç" të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

#### **V E N D O S A :**

1. Dënimin e kontrolluesit "SALUS" sh.a., me gjobë në vlerën **50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Kontrolluesi të kryejë në mënyrë të plotë dhe të saktë përditësimin e njoftimit sipas nenit 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, detyrim i cili të kryhet brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.

3. Kontrolluesi, spitali "SALUS" sh.a., në marrëdhënie me të tretët, edhe kur gjendet në kushtet e përpunuesit, domosdoshmërisht të realizojë dhe bashkëpunojë me kontraktuesin që e pajton për kryerjen e shërbimit "chek-up", mbi aneks kontratën tip të konfidencialitetit, sipas Udhëzimit Nr.19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, për përpunimin e të dhënave personale nga palë të treta.
4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot, më 12/04/2016

